

VENDIM
Nr. 507, datë 27.7.2022

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 597, DATË 13.10.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE DHE
OBJEKTEVE TË TJERA, QË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja “d”, e 2, të nenit 12, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 2, të vendimit nr. 597, date 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, pas nënndarjes “ii” shtohen nënndarjet “iii” dhe “iv”, me këtë përmbajtje:
“iii. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
iv. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.”.
2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj